

**VENDIM**  
**Nr. 75, datë 22.8.2014**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTEVE  
PRODHUESE TË SHOQËRISË “SA’GA-MAT” SHPK PËR HEC-ET “GERMAN 1”,  
“GERMAN 2”, “GERMAN 3” DHE “GERMAN 4” SI BURIM I RINOVUESHËM  
ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “ll”, 9 dhe 39, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 3 pika 1 germa “f”, të ligjit nr. 138/2013 “Për burimet e energjive të rinovueshme”, të ndryshuar, nenit 9, pika 1, dhe 2, germa “a” të “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.8.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Sa’Ga-Mat” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për kualifikimin e impianteve prodhuese të shoqërisë “Sa’Ga-Mat” sh.p.k. për HEC-et “German 1”, “German 2”, “German 3” dhe “German 4”, me fuqi totale 4.98 MW, si burim i rinovueshëm energjie,

**KONSTATOI SE:**

Aplikimi i shoqërisë “Sa’Ga-Mat” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE, të “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit. Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Dokumentacioni vijues grafik, korografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- Neni 7 pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”

Përshkrimi i centralit

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të fillojë procedurat për kualifikimin e impianteve prodhues të shoqërisë “Sa’Ga-Mat” sh.p.k. për HEC-et “German 1”, “German 2”, “German 3” dhe “German 4”, me fuqi totale 4.98 MW si burim i rinovueshem energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit Ahmeti**